

Njoftim i përqendrimit me të cilin ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, Republika e Kroacisë, do të fitoj kontrollin e drejtpërdrejtë mbi DEBA CEDARS INVESTMENT S.R.L., Bukuresht, Rumani

(lënda nr. 08-164/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 22.12.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin shoqëria ORBIKO SHPK Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, synon të fitoj kontroll të drejtpërdrejtë mbi DEBA CEDARS INVESTMENT S.R.L., me seli në rr. Elena Vakaresku Nr. 25, Blloku XX/4, Shkallët 1, Kati 2, Apartamenti 8, Sektori 1, Bukuresht, Rumani.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

ORBIKO SHPK Zagreb për tregti është një shoqëri e cila merret kryesisht me tregti me shumicë dhe njëkohësisht është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Kroacisë për një numër të madh të markave duke filluar nga produktet e kujdesit dhe bukurisë, produktet ushqimore dhe jo ushqimore, pajisjet teknike dhe elektrike, medikamentet, lodrat, tekstilet, cigaret, vajrat e motorit dhe shumë produkte të tjera tregtimi.

ORBIKO SHPK për tregti Zagreb ka një shoqëri të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

Shoqëria për tregti dhe shërbime **ORBIKO SHPK Shkup**, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Komuna Kisella Vodë, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe me NVAS 5024277, me veprimtari prioritare: 46.90 Tregti me shumicë jo e specializuar.

Objekti kryesor i operimit të ORBIKO SHPK Shkup është tregtia jo e specializuar me shumicë dhe në të njëjtën kohë është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një numër të madh të markave të produkteve të riprodhuara, vajrave motorikë, baterive, parfume, ujë tualeti dhe deodorantë, kozmetikë dekorative, produkte për higjienën personale, produkte për kujdesin (fytyrë dhe trup), produkte higjienike shtëpiake.

DEBA CEDARS INVESTMENT S.R.L., Rumani, me objekt operimi (veprimtari të rëndësishme) – 6420 aktivitete të shoqërive holding, është një shoqëri me qëllim të veçantë investimi që nuk realizon qarkullim por realizon të ardhura vetëm nga dividendët.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

27.12. 2022

Shkup

